

GAZMEND SHPUZA**KUVENDI I PARË I DIBRËS
(1 NËNTOR 1878)**

Kuvendi Themelues i Lidhjes Shqiptare, në qershor të vitit 1878, pavarësisht nga shkalla jo e plotë e përfaqësimit të viseve shqiptare, shpalli vendosmërinë e popullit shqiptar për mbrojtjen e tërësisë së trojeve amtare. Gjithashtu, delegatët që arritën të merrnin pjesë në të, përfshi dhe ata që erdhën me vonesë në Prizren nga vilajeti i Shkodrës dhe solidarizimi telegrafik i përfaqësuesve të Toskërisë, Abdyl Frashëri dhe Qazim Konica, e pajisën Lidhjen që në fillimet e saj edhe me programin kombëtar. Niveli autonomist i kërkesave i parashtruar në Prizren dhe tani në Dibër u diktua nga politika berlineze e Fuqive evropiane të kohës për ruajtjen e *status quo*-së së Perandorisë Osmane.¹ Kjo politikë e tyre në Ballkanin Perëndimor do të tregojë, për 30 e sa vjet, aq intransigjente ndaj shqiptarëve sa nuk do të përfillte as kërkesën e tyre për autonomi, edhe pse kjo nuk e cenonte politikën që ndiqnin në rajon.

Megjithëse kopja e Kararnamesë, që miratoi Kuvendi, mban dhe emrat e Abdyl Frashërit dhe të Qazim Konicës, si përfaqësues të viseve të Jugut, por jo nënshkrimet e tyre,² Kuvendi i Prizrenit nuk arriti ta realizonte plotësisht procesin e bashkimit të mbarë trojeve amtare rreth programit kombëtar të Lidhjes Shqiptare të shpallur që më 15 qershor 1878.

Procesi i bashkimit efektiv të të gjithë shqiptarëve rreth Lidhjes së Prizrenit nuk ka zgjatur deri më 2 korrik 1878, datë e cila konsiderohet se ka shënuar dhe fundin e punimeve të Kuvendit të Prizrenit.³ Ky Kuvend

¹ Një opinion i gabuar, deklaronte kryetari i delegacionit britanik në kryeqytetin gjerman, i vishte kongresit të sapombledhur, qëllimin për të ndarë një shtet të plakur dhe jo për të forcuar, siç ka bërë ky kuvend i lartë, një perandori të cilën e shikon si të domosdoshme për ruajtjen e paqes. Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (Përmbledhje dokumentesh dhe vështrim historik)*, I, Tiranë: 8 Nëntori, 1984, f. 175.

² S. Brestovci, “Karaarnameja-program i parë i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, VIII, Prishtinë: 1978 (1979).

³ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, Tiranë: Toena, 1997, f. 104-105.

nuk mund të zgjaste aq gjatë dhe i mbylli punimet e tij që më 17 qershor. Në krye të Lidhjes qëndroi Këshilli i Përgjithshëm i zgjedhur. Përbashkimi i plotë i shqiptarëve rreth programit kombëtar të Kuvendit të Prizrenit të 15 qershorit 1878 u realizua plotësisht në Kuvendin e Parë të Dibrës, në mbarim të muajit tetor të vitit 1878, tema e të cilit përbën objektin e këtij shkrimi.

Përfytyrimi i Kuvendit të Dibrës në historiografinë tonë deri në vitet '80 të shekullit të kaluar ka qenë tejet i zbehtë. Edhe në veprimtaritë shkencore dhe botimet dinjitoze të realizuara në kuadër të 100-vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, megjithë studimin e dokumentuar të prof. Masar Kodrës⁴ ai nuk zuri vendin që i takonte dhe për rrjedhim nuk pati as vlerësimin e duhur. Në një sesion shkencor të posaçëm, që u organizua në Peshkopi me atë rast, ku ishte dhe vendi që ky tubim të trajtohej posaçërisht, Kuvendi nuk u bë objekt trajtuese i një kumtese të veçantë.

Për Kuvendin e Parë të Dibrës, deri në prag të 100-vjetorit të Lidhjes bëhej fjalë, duke u mbështetur vetëm në dy letra që Abdyl Frashëri ia drejtonte ato ditë Iljaz Pashë Dibrës,⁵ në valën e përpjekjeve të tij për të siguruar angazhimin popullor në jug të vendit, në mbështetje të programit kombëtar autonomist të Lidhjes të riformuluar, siç do ta shohim më poshtë. Edhe ato dy letra qenë trajtuar ngushtë, pa vënë në pah rëndësinë reale të pjesëmarrjes aktive të Abdylit në Kuvend, si përfaqësues i Lidhjes Shqiptare për Toskërinë.

Pas ardhjes së delegatëve të jugut, Kuvendi mori karakter kombëtar përse i takon përfaqësimit, dhe veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit u shtri në mbarë trojet shqiptare. Kuvendi i Dibrës bashkërendoi përpjekjet e forcave atdhetare mbarëshqiptare për sigurimin e autonomisë së Shqipërisë dhe kundërshtimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit në favor të pretendimeve të Greqisë në jug të vendit.

Kuvendi i Dibrës u mblodh në atmosferën revolucionare të krijuar pas aksionit të armatosur të Gjakovës kundër misionit të Mehmed Ali

⁴ M. Kodra, "Veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit në territorin e sotëm të Maqedonisë", në *Konferenca shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, Prishtinë, 6-9 qershor 1978, I, Prishtinë: 1981, f. 159-161.

⁵ K. A. Dako, *Liga e Prizrenit e para lëvizje kombëtare për të mbrojtur tërësinë tokësore të atdheut dhe për të fituar independencën e Shqipërisë* (shoqëruar me dokumente zyrtare), Bucarest: 1922.

Pashë Maxharrit e mbështetësve të tij shqiptarë, jo vetëm myslimanë por dhe katolikë, nën drejtimin e Abdullah Pashë Drenit. Ngjarjet e atyre ditëve në Gjakovë dëshmuar qartë se Lidhja e Prizrenit ishte një organizatë e pavarur nga Porta e Lartë plotësisht e vendosur në mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut. Udhëheqja e saj iu kundërvu vullnetit kapitullues të Stambollit, të mundur nga armët ruse dhe të pafuqishëm përballë vendimeve të miratuara njëzëri prej Fuqive të Mëdha në Kongresin e Berlinit.

Dështimi i autoriteteve perandorake osmane në Gjakovë për t'i detyruar shqiptarët të mos kundërshtonin zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit për dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë rriti vendosmërinë e udhëheqësve radikalë të Lidhjes për parashtrimin edhe një herë të kërkesave mbarëshqiptare për autonomi të paraqitura Portës së Lartë nga Kuvendi i Prizrenit, më 15 qershor. Në ballë të këtij krahu, i cili u gjallërua kryesisht në Gjakovë, në Shkodër dhe në Dibër qëndruan Ahmet Efendi Koronica, Iljaz Pashë Dibra, Daut Efendi Boriçi e të tjerë dhe më aktiv i tregua Ali Pashë Gucia.

Rreth qëndrimit të përfaqësuesit kryesor të këtij grupimi, Ali Pashë Gucisë, në ato ditë, kryekonsulli austro-hungarez në Shkodër, Lippih, me skepticizmin, të përforcuar nga paragjykimet e tij ndaj Lidhjes së porsaformuar, nuk mungoi të raportonte nga Shkodra: “Unë ende besoj se Ali pashë Gucia me planin që ka, nuk ndjek qëllime serioze (!), se ai ka synimin që t’i japë Lidhjes së themeluar prej tij relievin e një kokëforti, duke ngulur këmbë *për t’u kthyer në programin fillestar të Lidhjes*”.⁶ (nënvizimi im - G. Sh.) Duke pasur parasysh veprimtarinë këmbëngulëse të themeluesve të Lidhjes në mbështetje të kërkesës për autonomi, Lippih e quan atë si përpjekje për krijimin e një “Lidhjeje të re”.

Në të vërtetë, tani themeluesit e Lidhjes punonin për angazhimin e njëkohshëm të organizatës mbarëshqiptare jo vetëm në luftën për mbrojtjen e trojeve shqiptare por dhe për realizimin e “programit fillestar” të saj, për autonominë e Shqipërisë, të riformuluar tashmë, në mënyrë më të plotë.

Për rishikimin e kërkesave të tij, Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes u këshillua me degët e Lidhjes që qenë formuar deri më atëherë, si dhe me

⁶ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HSt.A.PA.A.*), Raport nr. 91, Shkodër, 21 shtator 1878.

visë të tjera, kryesisht, në jug të Shqipërisë dhe me atdhetarët që punonin në Stamboll.⁷

Tani dilte detyra që të mbështeteshin përpjekjet që po zhvilloheshin në veri të Shqipërisë dhe në Stamboll për të shpалosur sërishmi para Portës së Lartë kërkesat autonomiste të miratuara që me krijimin e Lidhjes, më 15 qershor 1878, me kërkesën për administratën autonome të emërtuar “vilajetet e bashkuara”.

Kërkesat e Lidhjes së Prizrenit për krijimin e vilajetit të Shqipërisë, sipas tekstit të përpunuar tashmë, u botuan, së pari, siç njoftonte S. Frashëri, në gazetën “Istanbul”.⁸ Në to jepen të riformuluara dhe të plotësuara pesë pikat e programit të miratuar që në Kuvendin e Prizrenit, tashmë në shtatë pika.

Në pikën e parë, Lidhja deklaronte se ishte për ruajtjen e sovranitetit të sulltanit në Shqipëri dhe shprehte vendosmërinë e saj që asnjë pëllëmbë e tokës shqiptare nuk do t’u jepej shteteve të tjera. Me këtë pikë nuk shprehej aq shpresa e udhëheqësve të Lidhjes, se Stambolli do të angazhohej për ruajtjen e tërësisë së trojeve shqiptare. Ky nen nuk ishte, siç mëtohet, shprehje e otomanizmit të tyre, por përfundim i gjykimit realist se shqiptarët nuk do të ishin në gjendje t’u kundërviheshin njëkohësisht edhe vendimeve të Traktatit të Kongresit të Berlinit për copëtimin e trojeve shqiptare si edhe pajtimit të njëzëshëm të protagonistëve të tij për t’i zgjatur jetën sundimit osman në Shqipëri dhe më gjerë.

Me nenin e parë të programit hidhej poshtë propaganda spekulative e shteteve ballkanike rreth aspiratës strategjike të shqiptarëve për pavarësi, të shpallur më 13 qershor 1878 në Shkodër, nga e cila ata hoqën dorë menjëherë pas dy ditësh në vendimin e 15 qershorit.⁹ Tani ata u bënë

⁷ Komteti i Stambollit kishte pushuar së vepruari si i tillë. Anëtarët e tij revolucionarë, më i pari Pashko Vasa, Abdyl Frashëri e të tjerë, e përqëndruan tani veprimtarinë e tyre në Shqipëri. Nga Stambolli vetëm pas 2,5 vjetësh ndeshim një përkujtesë dërguar Fuqive të Mëdha në emër të Lidhjes së Prizrenit, më 15 prill 1881. Në të shprehet vendosmëria e popullit shqiptar për sigurimin e autonomisë dhe për mbrojtjen e atdheut përballë forcave të komanduara prej Dervish Pashës. *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare: 1878-1912*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1978, dok. nr. 75, f. 120-122.

⁸ Terxhuman-i Shark, v. I, nr.148, 15/27 shtator 1878; Shih dhe te: Sami Frashëri, *Vepra*, 1, përkthyer nga Vehxhi Buharaja, f. 218-219.

⁹ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ...*, dok. 11, f. 27-28.

idhtarë të autonomisë dhe nuk ndryshuan nga ky qëndrim deri në nëntor 1912.

Në pikën e dytë, kërkohej krijimi i vilajetit të Shqipërisë, si njësi e vetme politiko-administrative e të gjitha trojeve shqiptare. Me këtë avancohej në një stad të ri administrativ kërkesa e 15 qershorit për krijimin e “vilajeteve të bashkuara”.

Në pikat e tjera trajtoheshin parimet kushtetuese dhe administrative mbi bazën e të cilave do të organizohej dhe do të vepronte vilajeti i projektuar nga Lidhja. Të gjithë nëpunësit do të ishin shqiptarë. Në administratë e në shkollë do të përdorej gjuha shqipe. Osmanishtja do të përdorej vetëm në korrespondencën me Portën e Lartë. Vilajeti i Shqipërisë do të kishte ushtrinë e vet kombëtare.

Në Shqipërinë autonome të gjithë banorët, pa marrë parasysh dallimet fetare e shoqërore, do të kishin të drejta dhe detyra të barabarta. Vendi do të qeverisej nga organe vendore të zgjedhura në shkallë nahijeje (lokaliteti) dhe kazaje (rrethi). Çdo sanxhak (prefekturë) do të kishte këshillin e vet të zgjedhur periodikisht. Organi më i lartë do të ishte Kuvendi i Madh i vilajetit i zgjedhur nga këshillat e sanxhakëve, i veshur me pushtet legjislativ dhe ekzekutiv.

Kuvendi i Madh do të zgjidhte Këshillin (qeverinë) e vilajetit. Qeveria do të përgatiste ligjet, do të studionte reformat, do të hartonte buxhetin dhe do të zgjidhte gjykatën e përgjithshme, të cilat do t'ia paraqiste për miratim Kuvendit të Madh. Vendimet e Këshillit të vilajetit, thuhej në këtë program, do të zbatoheshin nga të gjithë banorët e vilajetit. Ato do të ishin të detyrueshme edhe për qeverinë perandorake osmane. Del qartë se për hyrjen e tyre në fuqi nuk pritej miratimi i saj. Nuk dokumentohet, siç pretendohet, që rreth këtyre kërkesave nëpër krahina të jetë hapur ndonjë diskutim, aq më pak nga sa shkruhet, i zjarhtë, ndërmjet “aktivistëve atdhetarë”, që e mbështetën programin e ri dhe “qarqeve” sulltaniste, të cilat u ngritën kundër përmbajtjes së tij. Elementë të tillë edhe pse nuk mungonin jo vetëm në veri të vendit, siç pretendohet, por dhe në jug të tij, nga sa rezulton në kërkimet e deritashme, nuk arritën të ngrihen, tani për tani, kundër vendimeve të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes.¹⁰

¹⁰ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena 2002, f. 172.

Ky program u ribotua më 27 shtator 1878, nga Sami Frashëri në gazetën “Terxhuman-i Shark” (Kumtari i Lindjes),¹¹ që dilte tani po në Stamboll, nën drejtimin e tij edhe pati jehonë dhe jashtë Perandorisë.

Jehonë të veçantë pati parashtrimi i programit të ri të Lidhjes Shqiptare nga Pashko Vasë Shkodrani.¹² Ideatori dhe organizatori kryesor i Kuvendit të Prizrenit dhe, njëkohësisht dhe hartuesi kryesor i akteve themeluese të tij të datave 15-17 qershor 1878, detyrë imediate të organizatës kombëtare mbarëshqiptare të porsa themeluar konsideronte luftën për mbrojtjen e çdo pëllëmbë toke shqiptare nga copëtimi i vendosur sipas Traktatit të Berlinit.

Pashko Vasa ripohonte sërishmi me forcë programin autonomist të miratuar në Kuvendin historik të Prizrenit, më 15 qershor, jo vetëm në praninë e tij, por dhe me kontributin e posaçëm që ai dha në formulimin e të pesë pikave dhe argumentimin e tyre para delegatëve. Ato ditë këshilltari i valiut të Kosovës, u shndërrua në organizatorin dhe formuluesin kryesor të vendimeve të Kuvendit historik të Prizrenit.¹³

Tani P. Vasa vijon saktësimin dhe qartësimin e mëtejshëm të vendimeve të mëparshme. Ai, gjithashtu, konkretizon se në “vilajetet e bashkuara” do të bënin pjesë përveç vilajetit të Shkodrës, Kosovës edhe ai i Janinës (vilajeti i Manastirit që suprimuar). Ata do të përfshiheshin në një provincë të vetme shqiptare me gjuhë zyrtare shqipen, me milici popullore të veçuar. Vilajeti i Shqipërisë do të administrohej nga përfaqësuesit e popullsisë vendase. Pashkoja parashtronte gjithashtu që provinca autonome do të qeverisej nga një regjim demokratik për kohën, i cili do t’u garantonte banorëve të drejta të barabarta pa dallim besimi dhe pozite shoqërore. Prof. K. Frashëri bën fjalë dhe për dy artikuj me “karakter programatik” të Abdyl Frashërit të botuar njeri më 27 shtator 1878 për publikun e brendshëm dhe tjetri, më 24 tetor 1878, për publikun e huaj, të cilët i paskan paraprirë Kuvendit të Dibrës.¹⁴

¹¹ S. Frashëri, *Vepra ...*, f. 218, Kërkesat e Lidhjes së Prizrenit.

¹² Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 162.

¹³ Gazmend Shpuza, “Pashko Vasa-ideologu i parë i madh i Rilindjes sonë Kombëtare”, në revistën *Perla*, nr.3, f. 5-92; po ai, “Pashko Vasa - sërishmi i harruar”, në revistën *Java*, 31 gusht 2013.

¹⁴ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 162. Për artikullin e parë i referohet gazetës “Terxhuman-i shark”, duke perifrastuar pikërisht kërkesat e Lidhjes Shqiptare, për të cilat bëjnë fjalë sa më sipër, publikuar prej Samiut, sipas gazetës “Istanbul”. Pra, nuk është fjala për një dokument personal të Abdylit.

Sipas shtypit rus, Pashko Vasa paralajmëronte Portën e Lartë që sulltani duhej ta pranonte “programin e ri politik, që shprehte kërkesat e shqiptarëve, në qoftë se nuk dëshiron kundërshtimin e armatosur të popullsisë së Shqipërisë”.¹⁵

Për artikullin e dytë që ia atribuon Abdylit, K. Frashëri i referohet gazetës “Messenger de Vienne”. Në të, me sa dihet nga sa ka botuar dhe vetë profesori, njihen disa korrespondenca nën okelion “Shqipëria” të muajve prill-qershor 1878, të shkruara, sipas tij, që të gjitha nga Abdylit. Porse, midis tyre, ai nuk ka përfshirë ndonjë korespondencë, e cila të mbajë datën 14 tetor 1878, Kjo mbështetje e pasaktë burimore nuk provon që Abdylit në ato ditë të ketë dalë publikisht, të paktën, në mbrojtje të variantit të ri të Programit autonomist të Lidhjes që do të shtrohej për diskutim në Kuvendin e Dibrës me përfaqësues nga e gjithë Shqipëria.

Autori grek Hasiotis nga Epiri, bashkëkohës dhe njohës i mirë i veprimtarisë së deriatëhershme të Abdylit, polemizon ashpër me të. Siç e pohon dhe vetë prof. Frashëri, autorësinë e artikullit të datës 26 prill 1878 me titull « Shqipëria dhe Traktati i Shën-Stefanit » dhe të artikullit frengjisht, ndryshe nga artikulli turqisht nuk ia njeh kundërshtarit të tij, deputetit të vilajetit të Janinës në parlamentin e parë osman.¹⁶

Përpyekjet për të shpjeguar arsyet e anonimatit të këtyre artikujve rezultojnë jo bindëse. Argumentet që sillen para lexuesve lidhur me përdorimin ose jo të emrit nga ana e Abdylit në njerin apo në tjetrin shkrim janë tejet kundërthënëse. Për artikullin turqisht të botuar në gazetën « Basiret » pranohet, me të drejtë, se tonit kategorik të përdorur prej autorit ia shtonte më tej fuqinë « nënshkrimi që mbante « letra » -

Për artikullin e dytë që ai ia atribuon, gjithashtu, Abdylit, autori i referohet gazetës “Messenger de Vienne”. Në të, me sa dihet nga sa ka botuar dhe vetë profesori, njihen disa korrespondenca nën okelion “Shqipëria” të muajve prill-qershor 1878, të shkruara, sipas tij, që të gjitha nga Abdylit. Porse, midis tyre, ai nuk ka përfshirë ndonjë korespondencë, e cila të mbajë datën 14 tetor 1878.

Biografinë “Abdyl Frashëri” të botuar, së parit, më 1984, prof. K. Frashëri e riboton më 2013 me një shtojcë dokumentare ku artikujt e gazetës vjeneze jepen edhe në shqip, edhe në frengjisht të shoqëruar dhe me disa faksimile. (Kristo Frashëri, *Abdyl Frashëri. Jeta, veprimtaria dhe shkrimet (1839-1892)*, Tiranë: 2013, f. 282-302).

¹⁵ Sh. Ajvazi, “Lidhja e Prizrenit më 1879-1881 në shtypin qendror rus”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, Prishtinë, VII, 1977, (1978); po ai, “Formimi, forcimi dhe zgjerimi i Lidhjes së Prizrenit sipas shtypit qendror rus”, në *Kosova*, Prishtinë 5 (1976) f. 97-115 .

¹⁶ Po aty, f. 124.

emri i një deputeti shqiptar, i një personaliteti të dalë nga fushata elektorale, i cili kishte më shumë se kushdo të drejtë të fliste në emër të bashkatdhetarëve të vet. Për këtë arsye « Letra nga Janina » krisi brenda dhe jashtë Shqipërisë », si një rrufe në qiell të kthjellët » konkludon autori.

Mirëpo, përkundrejt këtyre pohimeve shumë të drejta, për këtë artikull, mbetet i pashpjegueshëm fakti që pse në artikujt e tjerë që mbeten anonimë nuk funksionon e njëjta logjikë.¹⁷ Argumentet e sjella rreth arsyeve të përdorimit të anonimatit është më e mundshme të vlenin, një herë për një herë, vetëm për një funksionar të lartë osman, si këshilltari i valiut të Kosovës, Pashko Vasa. Prania e veprimtaria e tij mund të ushqente propagandën e qarqeve shoviniste fqinje, e cila mëtonte me të madhe, se prapa Lidhjes së Prizrenit qëndronin autoritetet osmane.

Idetë e shpalosura në gazetën austriake « Messenger de Vienne », për mendimin tim, janë shumë afër përfundimeve të analizave të hollësishme të parashtruara pas pak, në kryeveprën e Pashko Vasës dhe të literaturës politike të Rilindjes deri në fund të shek. XIX, « E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët », të skicuara që më parë të « Alfabetarje e gjuhës shqipe ». Nuk ka dyshim që në këto përfundime, edhe pse nuk i kemi të dokumentuara, të kenë arritur të gjithë udhëheqësit përparimtarë të Lëvizjes Kombëtare dhe të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri, Omer Prizreni e të tjerë. Porse prej tyre nuk mund të përjashtohet kurrsesi Pashko Vasa. Këtë e dëshmojnë gjithë dokumentacioni i kohës dhe botimet e tjera të tij, para dhe pas këtyre letrave, veçanërisht veprat e tij në gjuhën frënge.

Mbi bazën e platformës së ripërpunuar të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes u ftuan degët e Lidhjes së Prizrenit, sidomos ato të jugut, përfaqësuesit e të cilave nuk patën arritur të merrnin pjesë në Kuvendin themelues të saj, që ta miratonin atë. Pjesëmarrja e pavërtetuar ende, (me gjithë diskutimet që bëhen ende rreth saj e Abdyl Frashërit, emri i tij dhe i Qazim Konicës në një kopje të Kararnamesë, çka nuk pranohet nga vetë mbështetësit këmbëngulës të pjesëmarrjes së Abdylit në Kuvendin e

¹⁷ Ndërkohë në revistën “Messenger de Vienne”, sipas prof. K. Frashërit, ishin botuar edhe katër artikujt të tjerë të Abdylit pa emrin e autorit nën okelion “Korrespondenca të posaçme nga Janina “ (K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 132). Në të vërtetë, ato botoheshin nga redaksia me shënimin “Nga Shqipëria”.

Prizrenit¹⁸, dëshmon se bashkimi efektiv i përfaqësuesve të vilajetit të Janinës me qendrën e Lidhjes, me gjithë korrespondencat postare dhe telegrafike, ende nuk qe realizuar përfundimisht.

Në pritje të delegatëve që priteshin të vinin nga krahinat e jugut programi autonomist i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e vilajetit të Shqipërisë u shqyrtua dhe u miratua me ngut së pari në degën e Lidhjes Shqiptare për Dibrën, më 14 tetor 1878. Në këtë mbledhje, në të cilën morën pjesë përfaqësuesit e Dibrës, të qytetit, të Malësisë dhe të Fushës ai gjeti miratim të plotë.

Në këtë dokument programatik të mbledhjes paraprake të Dibrës pasi protestojë kundër copëtimit të trojeve shqiptare nga Kongresi i Berlinit, flitej për rrezikun e asgjësimit të Shqipërisë nga shtetet fqinje. Për t'u bërë ballë këtyre rreziqeve dhe për të siguruar të ardhmen e atdheut shtrohej si "kusht i domosdoshëm të kryhen një orë e më parë në sanxhakët e Shkodrës, Novipazarit, Prishtinës, Prizrenit, Shkupit, Manastirit, Dibrës, Beratit, Gjirokastrës, Prevezës dhe Janinës, të njohura me emrin Shqipëri,¹⁹ reformat e poshtëshënuara:

"E para: të gjitha viset e lartpërmendura të përmblihen në një vilajet dhe të caktohet si qendër një qytet, i cili të jetë afër dhe në lidhje me çdo anë të tij; e dyta: të gjithë nëpunësit që do të shërbejnë në Shqipëri duhet të dinë gjuhën e vendit;²⁰ e treta: të përhapet arsimit dhe në shkolla të mësohet edhe gjuha shqipe; e katërta: të zbatohen vendimet që do të merren për shtetin dhe për kombin nga ana e kuvendit të përgjithshëm, i cili do të mblihet katër muaj në vit në qendrën e vilajetit; e pesta të ndahet një sasi e mjaftueshme nga të ardhurat e përgjithshme të vilajetit për t'u shpenzuar për përparimin e arsimit si dhe për ndërtime publike".

¹⁸ Kristo Frashëri, "Pse them që Abdyli ishte në Lidhje", në *Gazeta Shqiptare*, 26 korrik 1992

¹⁹ Siç shihet, në këtë dokument saktësohet më tej shtrirja e trojeve shqiptare sipas sanxhaqeve, duke lënë jashtë katër vilajeteve perëndimore të Rumelisë sanxhakë në të cilët popullsia shqiptare nuk përbënte shumicën e tyre. Ky në fakt ishte koncepti territorial i Lidhjes i xhveshur nga ambicie shoviniste. Shih dhe Shyqyri Ballvora, "Koncepti i trojeve shqiptar sipas Lidhjes së Prizrenit", në *Studime historike*, I, 1978, 137-166.

²⁰ Në këtë pikë flitet për gjuhën e vendit, dhe jo për gjuhën shqipe, duke pasur parasysh që në këto sanxhaqe përfshiheshin dhe pakica jo shqiptare, të cilave Lidhja nuk ua mohonte të drejtat e tyre etnike e kulturore. Në fakt të drejtat kulturore atyre u qenë njohur prej kohësh me sistemin e mileteve.

“Me qëllim që këto pesë kërkesa, të cilat sigurojnë të ardhmen, përparimin dhe lumturinë tonë materiale dhe shpirtërore, - përfundon vendimi i miratuar në mbledhjen e Degës së Lidhjes për Dibrën, në praninë e Kryetarit të Lidhjes Shqiptare, Iljaz pashë Dibrës -t’ia paraqesin qeverisë duke i kërkuar lejen e lartë për vënien e tyre në jetë kemi caktuar si përfaqësues personat e quajtur...”²¹

Dokumenti i dalë nga dega e Dibrës, në praninë dhe me bashkë nënshkrimin (konfirmimin) e atypëratyshëm të Kryetarit të Lidhjes Shqiptare, Iljaz Pashës, përcjell vendosmërinë dhe gatishmërinë e përfaqësuesve të krahinave të veriut në parashtrimin e kërkesave për autonominë e të gjithë Shqipërisë pranë Portës së Lartë. Atë e nënshkruan, më 14 tetor 1878, Kryetari i Lidhjes Shqiptare Iljaz Dibra dhe kryetari i Degës së saj për Dibrën, Sadik si dhe 14 anëtarë të kryesisë së kësaj dege. Ky tubim përfaqëson miratimin e parë, të kërkesës së përgatitur nga organet e Lidhjes për krijimin e vilajetit të Shqipërisë, vendim i cili priste miratimin e përfaqësuesve të të gjitha viseve shqiptare.

Ndërkohë, kryeministri i atëhershëm i Perandorisë Osmane, Safet Pasha, në një shkresë drejtuar pallatit perandorak, më 31 tetor 1878, bën fjalë për dy memorandume të dërguar, në ato ditë, prej Lidhjes Shqiptare për Toskërinë, në të cilët i kërkohej qeverisë osmane njohja e Shqipërisë si vilajet autonom. Me gjithë kërkimet e kryera disa herë, në prag të 100-vjetorit të Lidhjes në arkivat e Stambollit në vitet ’70 të shekullit të kaluar, nga studiues nga Tirana dhe Prishtina nuk ka qenë e mundur të disponohen këto dy dokumente, çka do të shërbente për t’iu referuar letrave përcjellëse të autoriteteve vendore.

Nga sa i raportonte kryeministri osman pallatit sulltanor, përmbajtja e tyre ishte e njëjtë me rezolutën e miratuar nga dega e Lidhjes për Dibrën.²²

²¹ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 65-66; Iljaz Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane*, Prishtinë: 1978, f. 42-45. Prof. K.Frashëri, pa u mbështetur në asnjë dokument, mëton se programi i ri qenka formuluar në bazë të platformës së Komitetit të Stambollit, të kryesuar nga A.Frashëri. Në të vërtetë, siç e vumë në pah më sipër, ky Komitet kishte kohë që nuk vepronte më.

²² Shprehimisht Kryeministria i raportonte pallatit: “Përmbajtjen e dy memorandumeve të Lidhjes për Toskërinë e përbëjnë qëllime të këtilla siç janë:

Bashkimi i Shqipërisë, e cila përbëhet nga Gegëria e Toskëria, në një vilajet të vetëm, të gjithë nëpunësit e këtij vilajeti të njohin gjuhën shqipe, përhapja e arsimit dhe të mësuarit edhe të kësaj gjuhe në shkollat, formimi i një kuvendi të përgjithshëm,

Mbërritja te Porta e Lartë e dy memorandumeve me të njëjtën përmbajtje dëshmon, se ato qenë përcjellë në Stamboll, për mendimin tim, nga dy qendra banimi të ndryshme të Shqipërisë së Jugut.²³

Nxitimi i Lidhjes Shqiptare për Toskërinë për dërgimin e këtyre dy memorandumeve të veçuara, Portës së Lartë, para datës 31 tetor, me po ato kërkesa të miratuara dhe të shpallura në Dibër, para dy javësh, shpjegohet me shqetësimin e Abdyl Frashërit, se mos nuk arrinin të kontaktonin në kohë me Këshillin e Përgjithshëm të Lidhjes për bashkërendimin e veprimeve në shkallë mbarëshqiptare dhe paraqitjen bashkërisht të kërkesës për krijimin e vilajetit të Shqipërisë.

Ato dy memorandume janë dëshmi se Abdyl Frashëri me shokë në jug ishin në dijeni plotësisht rreth përfundimit në të cilin kishte arritur mbledhja e Degës së Lidhjes Shqiptare për Dibrën, më 14 tetor 1878. Në Dibër pritej ardhja e A. Frashërit me përfaqësuesit e tjerë të Toskërisë.

Udhëheqja e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në radhë të parë Këshilli i Përgjithshëm i Lidhjes së Prizrenit, ishin të informuar për punimet e Komisionit special të krijuar nga sulltani për diskutimin e gjendjes në Shqipëri si dhe të rrugëve për të dalë nga gjendja e krijuar atje. Të gjitha këto përshpejtime synonin t'i bënin të qartë Stambollit mbështetjen e shqiptarëve të jugut për kërkesat e parashtruara në Prizren dhe sidomos në Dibër më 14 tetor, përbënin thelbin e kërkesave të mbarë shqiptarëve. Me ta i bëhej e qartë qeverisë se thelbi i tyre nuk ishte bashkimi mekanik i vilajeteve shqiptare, siç po e trajtonte problemin komisioni në fjalë.²⁴ Projektet e Lidhjes Shqiptare, duke filluar nga “vilajetet e bashkuara” nuk kishin asgjë të përbashkët me propozimet që paraqiteshin në Komisionin sulltanor për vendosjen e një administrate të centralizuar policore dhe ushtarake represive në Shqipëri.

Lidhja e Prizrenit po punonte për realizimin e një veprimi të përbashkët të bashkërenduar në shkallë kombëtare në mbështetje të kërkesës për autonominë e vilajetit të Shqipërisë. Këtë detyrë e realizoi,

i cili do të mblidhet çdo vit nga katër muaj në qytetin që do të ishte qendra e vilajetit, zbatimi i vendimeve që do të merreshin në të, lidhur me reformat që do të ishin të dobishme për shtetin dhe për kombin, lenia [në Shqipëri] e një sasive të mjaftueshme nga të ardhurat e përgjithshme të vilajetit për arsimin dhe për punët komunale...”. (K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 69).

²³ Pretendohet, pa iu referuar asnjë burimi arkivor, se një dokument po me këtë përmbajtje i qenka nisur po më 31 tetor 1878, Portës së Lartë nga mbledhja ndërkrahinore e Janinës. (*Po aty*, f. 169).

²⁴ I. Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane ...*, f. 67, 71.

më 1 nëntor 1878, Kuvendi i Dibrës i kryesuar, sikurse pranon dhe Xhafer Belegu, nga Iljaz Pashë Dibra.²⁵ Kërkesat e miratuara në Dibër më 14 tetor 1878 i nënshkroi, më 1 nëntor 1878, edhe Abdyl Frashëri së bashku me përfaqësues të tjerë të Lidhjes për Toskërinë.²⁶

Rezoluta gjithëpërfshirëse e Kuvendit të Dibrës përmbante po ato kërkesa, të cilat ishin parashtruar në rezolutën e Degës së Lidhjes Shqiptare për Dibrën të 14 tetorit 1878, të përmbledhura tani në pesë pika: formimi i vilajetit të Shqipërisë, pajisja e tij me nëpunës shqiptarë, zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe, zbatimi i reformave nga Kuvendi i Madh, përdorimi i një pjese të madhe të buxhetit për përparimin e arsimit dhe për ndërtime botore.

Kuvendi vendosi, gjithashtu, siç parashtrohej në rezolutën e miratuar, që nga paria e krahinës së Gegërisë të zgjidheshin katër përfaqësues myslimanë dhe një i krishterë, kuptohet që të gjithë shqiptarë, gjithsej pesë persona. Këta brenda një muaji do të shkonin në Stamboll dhe në emër të të gjitha krahinave të Shqipërisë të parashtronin kërkesën për realizimin e këtyre pesë pikave nga Porta e Lartë.

Personat e parashikuar si pjesëtarë të dërgatës do të pajiseshin me letra përfaqësimi të autorizuara me vula zyrtare nga të gjitha kazatë dhe sanxhaqet, të cilat do t'iu dorëzoheshin sa më parë përfaqësuesve të Lidhjes që do të caktoheshin, sipas vendimit të Kuvendit, për t'i paraqitur kërkesat në Stamboll.

Në fund të rezolutës shprehej vendosmëria dhe gatishmëria, se Shqipëria, duke qenë “e lidhur dhe e bashkuar si një trup i vetëm”, do të rezistonte derisa të arrihej plotësimi i kërkesave të lartpërmendura.²⁷

Pas shprehjes së këtij qëndrimi të vendosur, delegatët e Kuvendit kombëtar të Dibrës paralajmëronin: “Çdo njeri që do të dalë kundër

²⁵ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimet e saj (1878-1881)*, Tiranë: 1939, f. 66.

²⁶ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi* (BOA), Sadaret hususi maruzati, tarih 5 zilkade 1295/20 tetor 1294/1 nëntor 1878; *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ...*, f. 69-70; I. Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane...*, Prishtinë: 1978, f. 46-47.

²⁷ Rezoluta përfundonte: “Derisa të arrihet plotësimi dhe realizimi i këtyre kërkesave, të cilat janë në interes të kombit dhe të shtetit, të gjitha krahinat e Shqipërisë do të qëndrojnë në një fjalë dhe kompakt, të bashkuar me një zë dhe për këtë qëllim nuk do të lënë pa përdorur çdo mjet që kanë.” (I. Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane...*, f. 46-47) Përgatitësi i botimit shënon: “Duhet të theksojmë se kjo fjalë është aprovuar vetëm nga Dega e Lidhjes së Dibrës dhe ndryshon nga vendimi i aprovuar po nga ky organ më 14 tetor të vitit 1881, ky dokument nuk është botuar askund..”.

këtyre kërkesave nuk do të konsiderohet shqiptar, por para të gjithëve njëherit do të llogaritet si armik i atdheut dhe i popullit tonë.”²⁸

Me përjashtim të frazës së fundit, vendimi i 1 nëntorit është i njëjtë me vendimin e miratuar vetëm nga Dega e Dibrës e 17 ditëve më parë. Kjo shtesë të çon në përfundime me shumë interes.

Udhëheqja e Lidhjes kundërshtarët e programit autonomist të saj nuk do t’i konsideronte shqiptar, por armiq të “atdheut e të popullit tonë”. Në këtë formulim duket qartë, se delegatët e Kuvendit të Dibrës nuk kishin parasysh atdheun “osman” dhe “miletin islam”, por vetëm popullin shqiptar dhe atdheun e tij, Shqipërinë, qëndrimet dhe synimet politike të të cilëve qenë parashtruar në Kuvendin e Prizrenit dhe tani në rezolutën e Dibrës, nga përfaqësuesit e të gjitha trojeve shqiptare.

Delegatët e Kuvendit të Prizrenit, para tre muajsh e gjysmë, qenë shpallur, duke u ngritur mbi besimet fetare që ushtroheshin në vend, pa dallim besimi, shqiptar.²⁹ Ky vetëmërtim etnik ishte shndërruar në një shprehje të qartë të vetëdijes kombëtare të përhapur tashmë gjerësisht dhe thellë në mesin e shqiptarëve. Këtë vetëdije të shpallur botërisht në Kuvendin e Prizrenit më 15 qershor 1878, tani, në Kuvendin e Dibrës drejtuesit e Lidhjes e ngrenë në normë jo vetëm morale për gjykimin e qëndrimit të veprimtarëve të saj ndaj Programit kombëtar të Organizatës mbarëshqiptare. Ajo tani kishte një forcë të tillë sa ata ishin të bindur se mund ta shndërronin në normë penale në rast moszbatimi të saj, të sigurt se krerët e lëkundur i trembeshin, tashmë, paralajmërimit që bëhej në vendimin e Kuvendit të Dibrës.

Në zbatim të vendimit të miratuar, më 1 nëntor 1878, që mbarë Shqipëria të mbështeste vendimin e Lidhjes iu dërguan sërishmi Stambollit, pas një jave edhe nga Dibra kërkesa për bashkimin e 11

²⁸ Prof. K. Frashëri, mëton, duke dashur të përforcojë mendimin e tij se pikëpamjet e Abdylit kanë qenë vendimtare në mos të vetmet, në formulimin e Rezolutës së Kuvendit të Dibrës qenka “hartuar nga dora e Abdyl Frashërit”. (Shih: K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 169) Si hartim ajo qe, siç e pamë, produkt i mendjes së përfaqësuesve të popullit shqiptar në Lidhjen Shqiptare, në qendrën e saj në Prizren dhe degët e saj jo vetëm në Veri, përfshijë dhe atdhetarët e Stambollit si dhe në Toskëri. Kontributi i Abdylit në këtë Kuvend ka qenë shumë i madh, prandaj nuk ka pse ai të reduktohet në atë të sekretarit teknik të tij. Këtë detyrë ka mundur ta kryejë shumë mirë një nga njohësit e gjuhës turko-osmane dhe nga një praktikant i zakonshëm i kaligrafisë osmane, të cilët nuk kanë munguar në Kuvend.

²⁹ S.Külçe, *Osmanli Tarihinde Arnavutluk*, Izmir: 1944, f. 250-251; G. Shpuza, *Kuvendime për historinë kombëtare*, Tiranë: 2000, f. 93-97.

sanxhaqeve shqiptare në një vilajet të vetëm. Interes të veçantë paraqet fakti që këtë dokument përveç përfaqësuesve të shumtë nga paria myslimane e Dibrës, kësaj radhe e nënshkruajnë dhe përfaqësues të parisë së krishterë si Naum Adhami, Naum Budhi dhe Borovani.³⁰

Në rezolucionin e 14 tetorit dhe në vendimin e 1 nëntorit emri i Iljaz Pashës shënohet sikurse në vendimin e Degës së Dibrës të 14 tetorit, të lexuar dhe përkthyer gabim si “Kryetari i Lidhjes i Dibrës Iljaz”. Ndërsa Abdyl nënshkruante, siç njihej zyrtarisht, Abullah Hysni, si përfaqësues i Lidhjes për Toskërinë.

Pavarësisht nga leximi dhe përkthimi jo i saktë në të dy rastet i dokumenteve këtu fjala është për Kryetarin e Lidhjes Shqiptare, Iljaz Dibrën dhe jo për kryetarin e degës së Lidhjes për Dibrën, siç jepet në të dy botimet e cituar, çka dhe pranohet përgjithësisht në literaturën tonë.

Përfaqësuesi i Toskërisë, Abdyl Frashëri, nuk do t’a nënshkruante këtë akt madhor vetëm me kryetarin e një dege të Gegërisë, qoftë kjo Dibra, që ndodhej pak a shumë në qendër të viseve shqiptare, dhe me një person me shumë autoritet qoftë ky Iljaz Pasha. Edhe kryetari i Lidhjes Shqiptare nuk do të pranonte ta mohonte organizatën kombëtare që përfaqësonte, sidomos në momente të tilla.

Në dokumentin osmanisht nënshkrimi i Kryetarit të Lidhjes Shqiptare, për mendimin tim, është lexuar gabim: “Reis-i cem’iyyet-i Debre Iliyas”, d.m.th. Kryetari i Lidhjes së Dibrës, Iljaz. Ai duhet të lexohet: “Kryetari i Lidhjes, Iljaz Dibra”.

Pavarësisht nga kjo lëkundje në leximin dhe përkthimin e nënshkrimeve të këtij dokumenti, këtu fjala është për Kryetarin e Lidhjes Shqiptare. Nuk bëhet fjalë për kryetarin e degës së saj për Dibrën, i cili, siç shënohet në dokumentin e 14 tetorit 1878 dhe në raste të tjera, ka qenë Sadik Beu (pashaj). Nga Dega e saj për Dibrën vendimin e nënshkruan 17 përfaqësues të komitetit drejtues.

Në këtë Kuvend, Abdyl shoqërohej, siç e pat vënë në pah dhe prof. Masar Kodra, fakt i injoruar deri më tani, edhe nga katër përfaqësues të tjerë të krahinave të Toskërisë, të cilët nënshkruajnë Ibrahim, Mustafa, Zejnel dhe sërishmi Ibrahim. Përderisa nuk shënohen titujt dhe gradat që mbanin, as përkatësia e tyre krahinore, mendohet se janë përfaqësues të njohur të atyre krahinave. Mbetet për të sqaruar kush qenë këta persona dhe, sidomos, cilat krahina përfaqësonin. Pavarësisht nga kjo, mbarë

³⁰ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ...*, Dok. nr. 34, f. 72.

Toskëria, në saj të veprimit konsekuent dhe energjik të Abdyl Frashërit, u përfaqësua në Kuvend në mbështetje të programit autonomist të Lidhjes.

Dibra, nga ana e saj, i shërbeu bashkimit efektiv të gjithë shqiptarëve rreth programit kombëtar të Lidhjes jo vetëm me pozicionin e saj gjeografik por dhe me atdhetarizmin e banorëve të saj dhe me autoritetin e Iljaz Pashës.

Këtë realitet e pranonin jo vetëm Abdyl por dhe M. Vlora dhe A. Dino, të cilët siç i shkruante Abdyl Beu, Iljaz Pashës, “si dhe paria e tërë Gegërisë, janë gëzuar jashtëzakonisht me sukseset Tuaja të jashtëzakonshme që keni treguar për të mirën e atdheut.”

Udhëtimi i Abdyl Frashërit në zbatim të detyrës së ngarkuar nga Kuvendi i Dibrës për sigurimin e letrave të përfaqësimit në viset e jugut për delegatët e Lidhjes që do të shkonin në Stamboll, ka zgjatur më tepër se një muaj.

Në veri të Shkumbinit, deri në Elbasan, veprimtaria e Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes së Prizrenit, siç del nga raportimi që Abdyl i bënte Iljaz Pashës, mbështetej në strukturat vendore të Lidhjes të konsoliduara tashmë.

Ndërsa në jug të vendit, në Berat, në Fier, në Vlorë, në Gjirokastrë, në Delvinë e në Çamëri nga Filati deri në Prevezë, dhe në vilajetin e Janinës përfshi dhe qendrën e tij, Abdyl Frashëri, siç i raportonte Iljaz Pashës, takoi përfaqësues të parisë vendase. Ai nuk bën fjalë për struktura vendore të Lidhjes. Ato, edhe aty ku qenë ngritur, me sa duket, nuk ishin konsoliduar ende.³¹ Veprimtaria e tyre, me sa duket, neutralizohej ende, nën trysinë e elementëve osmanë, nga rivalitetet e krerëve.

³¹ Në botimin serioz të akteve të periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të përgatitur me shumë kujdes nga prof. Selami Pulaha, të përfshira në botimin e përbashkët me prof. S. Pollo “Akte të Rilindjes...”, nga krahinat e jugut, pas më shumë se dy vjet, ndeshen dokumente të dala nga organet vendore të Lidhjes. Ata fillojnë nga viti 1880 me një dokument të nisur nga Paramithia. Deri më atëherë protestat, promemoret, e memorandumet nënshkrueshin në emër të mbarë Toskërisë ose të Shqipërisë së Jugut. Gjithë kjo ishte përfundim i përpjekjeve energjike dhe këmbëngulëse të A. Frashërit për të bashkërenduar forcat atdhetare të jugut përkrah organizmave të shumta të Lidhjes në veri të vendit. Sado që bëhet fjalë për mbledhje dhe kuvende ndërkahinore e krahinore si në Janinë, Gjirokastrë, Përmet e deri në ndonjë fshat, qoftë ky dhe Frashëri, (Kristo Frashëri, *Abdyl Frashëri, Jeta, veprimtaria dhe shkrimet 1839-1892*), Tiranë: 2013, f. 130-140 etj.), mbeten pohime të padokumentuara. Dhe faktikisht ata nuk kanë lënë asnjë gjurmë në dokumenacionin e pasur të atyre viteve. Për këtë arsye, veprimtaria e A. Frashërit, mbetet vendimtare jo vetëm për jugun por dhe në shkallë kombëtare.

Në letrën dërguar Iljaz Pashë Dibrës, më 2 dhjetor 1878, A. Frashëri njoftonte për entuziazmin që kishin shkaktuar kudo vendimet e Kuvendit të Dibrës si të myslimanët ashtu dhe të krishterët dhe gatishmërinë e përfaqësuesve të popullit shqiptar për të nënshkruar mandatet e përfaqësimit.

Mbi bazën e këtij entuziazmi Abdyli arriti t'i bashkojë rreth programit kombëtar këta krerë që ende nuk qenë organizuar si duhej nën drejtimin e degëve të Lidhjes. Prandaj Abdyli dhe personat që e shoqëronin vendimin e Kuvendit të Dibrës e nënshkruan si përfaqësues të Lidhjes për Toskërinë. Kështu, ai mundi të përfaqësoj duke i vënë në emërues të përbashkët të gjitha ato qendra të jugut të cilat arriti t'i përshkonte brenda kësaj kohe, afro një mujore. Ndërkaq nga sa njoftonte A. Frashëri, misioni për sigurimin e letrave të përfaqësimit për jugun e Shqipërisë vazhdonte.³²

Më aktivët për sigurimin e letrave të përfaqësimit për delegacionin e parashikuar në Kuvendin e Dibrës, më 1 nëntor, që do të shkonte në Stamboll, përveç A. Frashërit në sanxhakun e Janinës, u treguan dhe Mustafa Pasha në atë të Beratit si dhe Abedin Bej Dino në Çamëri.

Ata e lajmëronin kryetarin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, se së shpejti do të siguronin, sipas vendimeve të Kuvendit të Dibrës, letrat e përfaqësimit të Toskërisë në mbështetje të kërkesës për krijimin e vilajetit të Shqipërisë. Ndërkaq, me sa duket, përveç delegatëve që u caktuan në Dibër të shkonin në Stamboll për të parashtruar kërkesën për miratimin e autonomisë së vilajetit të Shqipërisë në dërgatën e caktuar të merrnin pjesë edhe Abdyl Frashëri, Mustafa pashë Vlora, Abedin bej Dino dhe krerë të tjerë të Shqipërisë së Jugut, që u treguan të gatshëm të shkonin dhe vetë në kryeqytet së bashku me përfaqësuesit e tjerë nga Veriu.

Abdyl Frashërit iu desh kohë të bindte Mustafa Vlorën që nisja e delegacionit nuk duhej vonuar, duke hedhur poshtë argumentet që ai nxori. Abdyl beu i ka përkujtuar, ndër të tjera, Mustafa pashës se “mu për shkak se Turqia është e angazhuar me çështjet e politikës së jashtme, është më se e nevojshme që të nisemi sa më parë për në Stamboll ... përpara se të merreshin vendimet lidhur me kërkesat e grekëve. Këto

³² I. Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane...*, f. 50-51.

çështje, theksonte ai me të drejtë, ishin të lidhura ngushtë me çështjen shqiptare.”³³

Këmbëngulja e Abdylit synonte të kapërcente lëkundjet e Mustafa Pashës, të Abdyl Bej Dinos e të tjerëve kur po shtrohej çështja e zbatimit të rekomandimeve të Kongresit të Berlinit lidhur me pretendimet greke në vilajetin e Janinës dhe më gjerë.

Në veri, sipas dokumentacionit jo të paktë që njohim, në këtë kohë, nuk ka pas ngurrime për këtë çështje. Nuk provohet që vendimet e Kuvendit të Dibrës të kenë ndeshur në rezistencën e fortë të sulltanistëve, edhe të Sheh Mustafa Tetovës, i cili në këtë kohë nuk paska qenë i prirur të krijonte “çështje” me Portën e Lartë pa marrë fund çështja e trojeve. Iljaz Pashë Dibrës iu paska dashur të punonte më tepër se dy muaj deri sa e theu më në fund rezistencën e Shehut, pjesëmarrjen e të cilit në delegacionin e Lidhjes Shqiptare e konsideronte të domosdoshme. Vetëm në fund të muajit janar 1879, Kryetari i Lidhjes e paska njoftuar A. Frashërin se përfaqësuesit e krahinave veriore ishin gati për t’u nisur në Stamboll. Ndërkaq vijohet të pohohet se më 1 nëntor parashihej që dorëzimi i rezolutës së kuvendit të dorëzohej brenda vitit. Në mënyrë të papazuar konkludohet se paska qenë vonesa për caktimin e përfaqësuesve të veriut që kishte prishur punë.³⁴

Ndërsa vetë Abdyl, në të dy letrat drejtuar Iljaz Pashës, dokumenton se qenë ngurrimet e dy krerëve më të rëndësishëm të jugut të cilët zvarritën nisjen e delegacionit të Lidhjes për në Stamboll. Ata kërkuan të gjendej koha e përshtatshme për ta ngritur çështjen e autonomisë së Shqipërisë pranë Portës së Lartë. Në fakt, qe Mustafa Pashë Vlora ai që

³³ “Nëse çështja bullgare zgjidhet në pajtim me vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, (?) kurse çështja greke në harmoni me vendimet që merren në Kongresin e Berlinit, atëherë gjysma e viseve të Shqipërisë (Arnautllukut), do të binë nën dominimin e armiqve, kurse Lidhja jonë dhe bashkimi ynë nuk do të ketë kurrfarë vlere. Nëse përfaqësuesit e viseve shqiptare arrijnë në Stamboll para se të trajtohen këto dy çështje, me siguri do të kemi dobi të madhe.” Pas nënshkrimit të Traktatit të Berlinit nuk mund të bëhej fjalë më për rreziqet që do t’i vinin Shqipërisë nga Traktati i Shën Stefanit dhe pretendimet e Bullgarisë mbi trevat shqiptare ranë përfundimisht. Nga data kur është shkruar letra në përmbajtjen e saj ka një non sens, pak të quhet, të çuditshëm. Paqartësitë në letrën e Abdylit vijnë. Ai i kërkonte kryetarit të Lidhjes Shqiptare: “Ju lutemi njëkohësisht që të dërgoni sa më parë autorizimet e përfaqësuesve të Gegërisë, të cilat duhet të dërgohen në Stamboll, dhe si të bëheni gati, të lajmëroni Mustafa pashën, Mehmet Ali beun dhe mua” (*Po aty*)

³⁴ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 170.

kishte këmbëngulur pranë Abdyl Beut që të shtyhej nisja e delegacionit për në Stamboll dhe këtë ai e kishte lidhur me nisjen e Iljaz Pashës.

Rreth ngurrimit të krerëve në jug të vendit për të marrë pjesë në delegacionin që do të shkonte në Stamboll dëshmon qartë qëndrimi që mbajti Kuvendi i Prevezës pak ditë më vonë, më 11 janar 1879. Delegatët e vilajetit të Janinës të cilët e quajtën veten “krerë të Shqipërisë” në vendimet që morën atë ditë, nuk e mbështetën rezolutën e Kuvendit të Dibrës të para dy muajve. Ata nuk iu referuan fare asaj dhe e kaluan në heshtje kërkesën themelore të tij për krijimin e vilajetit të Shqipërisë.³⁵

Së fundi, Abdyl vijon ta njoftojë, më 21 dhjetor, Iljaz Pashën, se si përfaqësues të Toskërisë kishin vendosur të shkonin në Stamboll një grup mjaft i gjerë dhe konkretisht Mustafa Pashë Vlora, Abedin Bej Dino, Mehmed Ali Bej Vrioni, Sabri Bej Gjirokastra ose Ahmet Efendiu dhe, çka kishte mjaft rëndësi, nga të krishterët, Mihal Kristo Efendia dhe vetë Abdyl.³⁶

Duke vlerësuar autoritetin e lartë që kishte siguruar kryetari i Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashëri i drejtohej Iljaz Pashës me titullin “Shkëlqesi” dhe e përfundonte letrën e vet me shprehjen “Në këtë pikëpamje urdhëri i takon Shkëlqesisë Suaj”. Me këtë formulë në administratën e lartë osmane iu drejtoheshin ministrave, kryeministrit e deri te sulltani.

Abdyl Frashëri edhe në letrën tjetër, dërguar Iljaz Pashës më 21 dhjetor 1878, shpreh rishtazi shqetësimin që përfaqësia shqiptare duhej të nisej sa më parë për në Stamboll dhe ripërsërit arsytet, duke përforcuar argumentet e mëparshme. Në rast të marrjes së vendimeve që lidhen me Shqipërinë, me siguri ata nuk do të ishin të volitshme por të dëmshme, kurse e ardhmja dhe ekzistenca e viseve shqiptare dhe e popullit shqiptar do t’i ekspozoheshin shkatërrimit të plotë.³⁷

³⁵ Shih: *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ...*, f. 74; shih dhe K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 175.

³⁶ Sipas Abdyl Frashërit, përfaqësuesit e Gegërisë duhet të ishin Iljaz Pasha, Hasan Pasha, Sheh Mustafa Efendiu dhe personat e tjerë të zgjedhur. Me persona të zgjedhur ai, me sa duket, kishte parasysh vendet e lëna bosh në tekstin e vendimit të Kuvendit të Dibrës. Nuk kuptohet, ç’nevojë kishte dhe ku mbështetej ai kur i njoftonte kryetarit të Lidhjes anëtarët e delegacionit nga Gegëria, përfshi dhe vetë Iljaz Pashën.

³⁷ “Tani në Stamboll duhet të mirren vendime përfundimtare rreth çështjes greke dhe bullgare, si dhe rreth mënyrës së qeverisjes së Shqipërisë-viseve shqiptare që kanë të bëjnë me ndarjen e viseve shqiptare me qëllim që këto t’i jepen Greqisë dhe Bullgarisë. Edhe në se merren vendime që të formohen vilajete të reja, viset shqiptare

A. Frashëri vijon se Mustafa Pasha e kushtëzonte vajtjen e tij në Stamboll me vajtjen e Iljaz Pashës dhe në se ai nuk do të shkonte nuk do të shkonin as delegatët e tjerë, për të cilët ai e kishte informuar Kryetarin e Lidhjes në letrën e mëparshme.³⁸

Përfundimisht, vetë Abdylit, ndërsa i bënte thirrje Iljaz Pashës, i shqetësuar me të drejtë, mbetej i mbërthyer nga hezitimet e theksuara të krerëve të tjerë të jugut. Për këtë arsye, ai dëshmoi, dashur pa dashur, mungesë iniciative. Pasi pranonte: “Në se kjo punë shtyhet edhe më tutje, atdheu ynë do të jetë në rrezik, kurse ardhmëria jonë do të shkatërrohet”, Abdylit i drejtohej Kryetarit të Lidhjes me përlule: “ E presim urdhërin e Shkëlqesisë Suaj.”

Siç shihet, përfaqësia e Shqipërisë së Jugut që ishte parashikuar të shkonte në Stamboll për të paraqitur programin e Kuvendit të Dibrës tani, pas afro tre javësh, kur do të kundërshtonte dhe pretendimet greke mbi Shqipërinë e Jugut, sipas rekomandimeve të Kongresit të Berlinit, ishte përgjysmuar.

Kushtëzimi i pjesëmarrjes së Mustafa Pashë Vlorës në përfaqësinë e Toskërisë që do të nisej për në Stamboll për të mbështetur kërkesën për krijimin e vilajetit të Shqipërisë nga ana e pjesëtarëve të tjerë të saj duhet shpjeguar jo vetëm me autoritetin ndërkrainor të tij, por dhe me lëkundjet që u shfaqën midis tyre. Ndërsa ndërlidhja që pashai vetë i bënte, sipas Abdylit, nisjes së tij me atë të Iljaz Pashës shpjegohet veçanërisht me autoritetin kombëtar që kishte fituar Iljaz Pasha në krye të Këshillit të Lidhjes Shqiptare që nga krijimi i saj (pa përjashtuar edhe lëkundjet sipërpërmendura). Në këtë drejtim ndikonin veçanërisht, aksioni kundër Mehmet Ali Pashë Maxharrit dhe sidomos mbrojtja e Plavës dhe e Gucisë. Veprimtaria e deritashme e Lidhjes përbënte një kapital të madh politik dhe moral në mobilizimin e shqiptarëve në jug për t'i bërë ballë pretendimeve greke të mbështetura nga rekomandimet e Fuqive të Mëdha, veçanërisht nga Rusia në Berlin.

do të ndahen përsëri-do të copëtohen në disa vilajete, kurse qendrat e këtyre vilajeteve do të jenë Selaniku, Janina dhe Manastiri. Në këto vilajete gjuha greke dhe bullgare do të përdoren si gjuhë vendore”. (I. Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane...*, f. 52-53).

³⁸ Ai shprehte besimin se “Për shpëtimin e viseve shqiptare” dhe “për të mirën e atdheut dhe të kombit” Iljaz Pasha do ta merrte mbi vete “këtë detyrë të shenjtë” dhe do të shkonte në Stamboll.” Letra mbyllej me lutjen që, pasi të merej vendimi për shkuarjen në Stamboll, “t’i lajmëroni përfaqësuesit e tjerë: Mustafa Pashën, Mehmet Ali Bej Beratit dhe mua.” (*Po aty*)

Për këto arsye, veç të tjerash, është plotësisht e kuptueshme këmbëngulja e A. Frashërit për nisjen sa më të shpejtë bashkërisht të përfaqësuesve të Lidhjes për në Stamboll.

Themeluesit e Lidhjes me Pashko Vasën, Iljaz Pashën dhe Ali Pashë Gucinë në krye i kishin pasë të qarta që në pranverën e atij viti arsyetimet e parashtruara tani Mustafa Pashës dhe krerëve të tjerë të jugut nga Abdyl Frashëri. Mbi bazën e tyre ishin marrë vendimet e Kuvendit të Prizrenit të përforcuara, tashmë, në vendimin e përbashkët me përfaqësuesit e Toskërisë.

Me shumë interes për vlerësimin e Kuvendit të Dibrës paraqitet qëndrimi i valiut të Kosovës ndaj vendimit të tij me kërkesën për formimin e vilajetit shqiptar, në të cilin trojet tona do të mblihdeshin nën një administratë të vetme. Relacioni i dërguar, pas dy javësh, Portës së Lartë, më 14 nëntor 1878, mbështetet në informata të sakta rreth vendimit të marrë.³⁹

Menjëherë vali u shpreh rezervat e tij rreth qëllimit të pjesëtarëve të tij, sepse vetëm në pamje të parë dukej sikur niseshin nga qëllime të mira. Në qoftë se thelbi i projektit të tyre synonte vetëm atë që në vend të nëpunësve që dërgonte Stambolli në Shqipëri do të viheshin krerët e tyre, që do të drejtonin vetë punët dhe jetën e tyre dhe të fitonin ndikim dhe famë, atëherë problemi, paralajmëronte ai, kërkonte vëmendje të veçantë.

Dështimi i reformave tanzimatiste të Portës së Lartë në Shqipëri për të zbatuar “gjithë farë masash përmirësuese dhe reformash”, duke dërguar herë pas here në Shqipëri forca ushtarake, duke zbatuar ligje dhe

³⁹ “Nuk është e panjohur edhe për shkëlqesinë tuaj z. kryeministër se baza e Lidhjes së këtyre [shqiptarëve] qëndron në formimin e një vilajeti të vetëm, të përbërë nga krahinat e Shqipërisë që quhen Gegëri dhe Toskëri, që do të ketë një qendër të përshtatshme dhe që do t’i ngarkohet për administrim një vali u të denjë të emëruar nga ana e Perandorisë; (me synim) sigurimin e një administrate autonome, në të cilën ata t’i emërojnë vetë nëpunësit e nevojshëm dhe t’i caktojnë vetë rregulloret e brendshme. Vetëm se kjo administratë do të ndërtohej në një mënyrë të tillë që në çdo rast të mos shkëpuste lidhjet me Perandorinë Osmane dhe të mbetej nën mrojtjen e kësaj. Dhe kjo paska për qëllim që nga forcat islamike dhe nga pushteti i Perandorisë Osmane që kanë mbetur në Rumeli, të formohet një fuqi e madhe e përbashkët; kështu Rumelia në të ardhmen nuk do të mund të mposhtet ose të invadohet nga shtetet e ndryshme që e rrethojnë, nga ndonjëri prej vendeve sllave, ose nga Greqia. Këto qëllime [të shqiptarëve] qenë kuptuar që në atë kohë kur unë ndodhesha në Janinë. Ja pra në këto [dy] vendime paraqiten plotësisht vendimet e tyre”.

“Dokumente e materiale”, në *Studime historike*, nr. 2, 1978, f. 244-246; Shih dhe I. Rexha, *Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane...*, f. 48-50.

rregullore dhe duke çelur shkolla në gjuhën osmane, nuk e kishte nxjerrë Shqipërinë nga prapambetja. Që këtej ai përpiqet të bindë veten dhe eprorët, se “në qoftë se tani frenat e qeverisjes dhe gjithë administrimi i këtyre viseve do të kalonin në duart e një populli i cili ende është i privuar nga nderi për të qenë i qytetëruar e me kulturë ... krerët (shqiptarë) nuk do të merreshin vesh me njeri-tjetrin”.

Pavarësisht nga justifikime të tilla,⁴⁰ vali i Manastirit e shpreh qartë shqetësimin e vërtetë rreth pasojave që do të kishin këto “farë ngatërresash” në Shqipëri. Brenda disa vjetësh “këto krahina të na dilnin nga duart. Mendoj se kjo është një gjë aq e qartë dhe e dukshme sa askush nuk do të mund ta mohojë.”

Në kushtet e krijuara, vilajeti i Shqipërisë, sipas valiut, duhej t’u ngarkohej njerëzve të besueshëm me përvojë në çështjet politike dhe civile, të aftë për të përballuar kërkesat e tepruara autonomiste të shqiptarëve. Nga ana tjetër, ai këshillonte, se kundërshtimi i të gjitha kërkesave të tyre do të ishte i rrezikshëm: “Kjo do të bënte që ata më vonë, për shkak të predispozicionit të tyre të ndërmerrnin, ashtu si kretasit, veprime këmbëngulëse për të fituar autonominë. Prandaj është e nevojshme që gjendja në këtë vend të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme e të hollësishme nga ana e Portës së Lartë. Nga këtej ai arrin

⁴⁰ Dashur pa dashur ai nuk arrin të fshehë disa nga shkaqet e vërteta të dështimit të reformave centralizuese të Tanzimatit: “Në të vërtetë, edhe me reformat që u ndërmorrën nga Perandoria para ca kohësh u bënë shpërdorime. Ata u përlyen duke pësuar gjithfarë ndryshimesh që iu bënë gjatë ndërrimit të nëpunësve, duke humbur kështu qëllimi i tyre themelor. Nuk mund të mohohet se masat që u quajtën reforma sollën si përfundim vetëm trazira dhe ngatërresa.” (*Po aty*, f. 66-67)

⁴⁰ Vështirë të dokumentohet në se këto mendime të kenë qenë thjesht pikëpamjet personale të valiut apo dhe të këshlltarit të tij. Interes do të kishte gjithashtu në se do të kishim në dorë letrën përcjellëse të prefektit të Dibrës. Ai ka qenë në kontakt me krerët.

Më 24 prill 1879 kryeministria i paraqiste pallatit perandorak procesverbalin e përfundimeve në të cilat kishte arritur komisioni special i ngritur me urdhër të sulltanit për të shqyrtuar gjendjen e krijuar në Shqipëri nga lëvizja popullore e udhëhëqur nga Lidhja e Prizrenit prej afro dy vjetësh. Gjatë këtyre muajve, përveç aksionit të Gjakovës të drejtuar kundër misionit të Mehmet Ali pashë Maxharrit nuk kishte pasur asnjë përpjekje tjetër të armatosur të forcave të Lidhjes kundër atyre osmane. Megjithatë procesverbali i kryeministrisë gjithë këtë periudhë e quante **kryengritje**, e cila sipas relatorëve e bënte jo vetëm të nevojshme por dhe të domosdoshme të ndërmerreshin reforma, kuptohet shtrënguese, duke filluar nga organizimi i vijejeteve perëndimore të Rumelisë e Kuvendit të Dibrës. (*Po aty*)

në përfundimin, që “Shqipëria të futet nën një administrim ushtarak, i cili do të ishte në dobi të Perandorisë.”⁴¹

Me relacionin e tij, vali i Kosovës përforconte mendimet që ekzistonin në komisionin special të krijuar nga Porta e Lartë për të diskutuar kërkesat e Shqiptarëve për autonomi. Kërkesat e Lidhjes Shqiptare që nga Kuvendi i Prizrenit i 15 qershorit 1878 dhe deri te ai i Dibrës, 1 nëntor 1878, në të cilën u përfaqësua edhe Toskëria, për bashkimin e trojeve shqiptare në vilajetin e Shqipërisë, i diktuan këtij komisioni të merrte në shqyrtim dhe kërkesat autonomiste të shqiptarëve.

Nuk ka dyshim që Ali Pashë Gucia dhe Iljaz Pashë Dibra (Qoku) në këto ditë luajtën një rol shumë të rëndësishëm për parashtrimin e miratimin e programit të ri të Lidhjes Shqiptare. Me ta u bashkua me vendosmëri dhe energjikisht Abdyl Frashëri në emër të Lidhjes për Toskërinë, duke realizuar jo pa vështirësi bashkimin e viseve jugore me këtë program.⁴²

Në gjithë këtë veprimtari organizative dhe politike për ta ngritur luftën për autonomi në një shkallë të re vlen të theksohet roli vendimtar dhe i pazëvendësueshëm i Iljaz Pashë Dibrës, kryetar i Lidhjes mbarëshqiptare të Prizrenit. Ai nuk qe kryetar honorifik, siç paraqitet, por aktiv në krye të dy kuvendeve të para vendimtare të Lidhjes Shqiptare, në Kuvendin themelues të Prizrenit dhe në Kuvendin përbashkues të Dibrës të vitit 1878, pa bërë fjalë për Kuvendin e dytë të Dibrës (1880).

Nga sa parashtrohet më sipër, besohet se zhdavaritet paqartësia lidhur me përgjigjen e pyetjes “Kush ka qenë kryetari i Lidhjes Shqiptare

⁴¹ Vështirë të dokumentohet në se këto mendime të kenë qenë thjesht pikëpamjet personale të valiut apo dhe të këshlltarit të tij. Interes do të kishte gjithashtu në se do të kishim në dorë letrën përcjellëse të prefektit të Dibrës. Ai ka qenë në kontakt me pjesëmarrësit e Kuvendit.

⁴² Lidhja e Jugut, sipas dokumenteve që posedohen, më 22 mars 1879, e ndodhur nën trysinë e rrezikut shovinist grek mbi viset jugore në memorandumit e drejtuar Fuqive të Mëdha mjaftohet përsëri me kërkesën e formuluar në mënyrë të përgjithshme, për respektimin e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar. Në këtë frymë, më 9 korrik të atij viti nga Stambolli, duke protestuar kundër pretendimeve greke ndaj Shqipërisë së Jugut, autorët e memorandumit në fjalë, kujtojnë se sa telegrame, parashtrësia, memorandumet u janë dërguar nga anë të ndryshme të Shqipërisë Fuqive të Mëdha. Synimi i autorëve të dokumentit në fjalë tashmë, pa iu referuar Kuvendit të Dibrës tani shprehej me terma paksa të rrumbullakosura: “të njihen të drejtat tona kundër lakmisë së fqinjëve, dhe për të bërë që të respektojnë tërësinë e atdheut tone dhe të shqyrtojnë nevojat tona, që kështu të na jepet një ligj organik i përshtatshëm për karakterin e popullit tone”.

të Prizrenit?”, e mbështjellë ende nga legjendat urbane dhe rurale që e kanë shoqëruar që prej dhjetëra vjetësh.

Pikërisht veprimtaria e spikatur e Iljaz Pashës në krye të Lidhjes e dallon qartësisht atë nga mijëra veprimtarë të Rilindjes si dhe nga dhjetëra drejtues të Lidhjes. Për këtë arsye, karakterizimi që i bëhet atij kohë e fundit, edhe pse përpiqet të shkëputet nga stereotipet e mëparshme, nuk arrin ta japë atë të saktë dhe të plotë.⁴³

Iljaz Pashë Dibra është njëri prej organizatorëve kryesorë të Kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryetari i këtij Kuvendi historik dhe kryetari i parë dhe deri në fund i Lidhjes. Deri këtu Iljaz Qoku (Dibra) kishte ardhur pas një veprimtarie të shquar atdhetare për mbrotjen e trojeve amtare dhe sigurimin e vetadministrimit të tojeve shqiptare.

Iljaz Pashë Dibra, i dalluar, që më 1860, në përballimin e sulmeve të forcave shoviniste malazeze në vilajetin e Shkodrës, në krye të Këshillit të Përgjithshëm dëshmoi vendosmërinë e tij në luftërat e Lidhjes për të hedhur poshtë klauzolat e Traktatit të Shën Stefanit dhe vendimet e Traktatit të Berlinit në kurriz të tërësisë së trojeve shqiptare. Jo vetëm kaq.

Iljaz Dibra qëndroi në ballë të Kuvendit dhe të Këshillit të Përgjithshëm të Lidhjes për formulimin dhe parashtrimin e programit autonomist të shqiptarëve. Ai vinte në krye të Lidhjes me përvojën e luftërave që kishte zhvilluar që në moshë të re, më 1844, kundër forcave osmane të Hajredin Pashës dhe përpjekjeve të Portës së Lartë për zbatimin e reformave centralizuese. I pajisur, tashmë, me një vetëdije të spikatur kombëtare Iljaz Qoku, në pranverë të vitit 1878, u vu së bashku me kuvendarët dhe pjesëmarrës të tjerë të kuvendit, në radhë të parë, me Pashko Vasë Shkodranin, në ballë të luftës për sendërtimin e programit të autonomisë administrative kombëtare të vilajeteve të bashkuara shqiptare. Me autoritetin dhe prestigjin që gëzonte punoi energjikisht pa marrë parasysh moshën për bashkimin e viseve të tjera shqiptare rreth programit kombëtar të Lidhjes, siç e pamë, në Kuvendin e Dibrës më 14 tetor/1 nëntor 1878, të kryesuar po prej tij. Ai nuk qëndroi, siç pretendohet, i tërhequr në çifligjet dhe sipërmarrjet e tij, por u vu në ballë

⁴³ *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2007, f. 473-474.

të luftës trevjeçare të popullit të vet në këto momente jetike për fatet e Atdheut.

Iljaz Pashë Dibra veproi aktivisht në krah të ideologut të madh të Rilindjes, Pashko Vasë Shkodrani, në Kuvendin e Prizrenit për themelimin e Lidhjes. Pashkoja, nga ana e tij, i mbështetur në përvojën politike e administrative dhe veprimtarinë e gjerë shkencore e publicistike, u shpreh në mbrojtje të çështjes shqiptare në mënyrë lapidare në promemoret e tij drejtuar vetëm apo bashkë me mendimtarë të tjerë diplomatëve të huaj në Stamboll.

P. Vasa me Iljaz Pashë Dibrën, Ali Pashë Gucinë e të tjerë në krah, mundësuan krijimin e qendrës së Lidhjes mbarëshqiptare në Prizren nga e cila u varën, pavarësisht nga vështirësitë e pengesat organizative si dhe sabotimet e elementëve sulltanistë, të gjitha degët në mbarë qytetet shqiptare që nga Shkodra në Shtip të Maqedonisë së sotshme dhe deri në Prevezë në Janinë.

Ato ditë të qershorit shqiptarët arritën një nga marrëveshjet më madhore, historike mes vetes, me njeri-tjetrin. Për të mbërritur deri aty ata kapërcyen politikisht pasojat e prapambetjes ekonomike të shkaktuar nga sundimi i gjatë osman; kapërcyen përçarjen krahinore dhe veçanërisht pasojat e dasive fetare. Elementët më të përparuar nga paria çifligare e bajraktare u ngritën mbi separatizmat e tyre karakteristike.

Pashko Vasa, në ato ditë të qershorit të vitit 1878, ua bënte të qartë diplomatëve të Evropës në Stamboll dhe në Rumeli, se Lidhja e udhëhequr efektivisht nga Iljaz Pasha po fliste me forcë me gjuhën e aspiratave europianiste.⁴⁴

Zejtari i shquar, sipërmarrësi i madh i taksave dhe çifligari Iljaz Pashë Qoku qëndroi në radhët e para të udhëheqësve më të përparuar dhe më të vendosur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në vitet 1878-1881. Në krye të Lidhjes ai së bashku me Pashko Vasën, Ali Pashë Gucinë, me Abdyl Bej Frashërin, Daut Efendi Boriçin, Hodo Pashë Sokolin e dhjetëra të tjerë në ballë të Lidhjes dhe të degëve e të forcave luftarake dhe më së fundi dhe të organeve të qeverisë së saj, të kryesuar nga Omer Efendi Prizreni, vunë gurin në themelet e Pavarësisë.⁴⁵

⁴⁴ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare: 1878-1912*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë – Instituti i Historisë, Tiranë 1978, f. 68.

⁴⁵ Qenë të gjithë këto së bashku, jo vetëm Abdyl, me ideologun e Lidhjes Pashko Vasë Shkodranin në krye, të cilët sollën në Prizren dhe në Dibër, në Shkodër e më gjerë, “një ide, një horizont për dëshirat dhe kërkesat”, siç shkruante Mit’hat Frashëri, më

Shfletimi i dokumenteve programore të Lidhjes Shqiptare, të miratuara dhe të shpallura në dhjetëditëshin e dytë të muajit qershor të vitit të vrullshëm 1878, në Prizren, dhe më 14 tetor të po atij viti në Dibër, hedh poshtë pretendime të tilla me frymë të thelluar lokaliste dhe nepotike. Më 1 nëntor 1878 “ideali i ri”, i shpalosur që më 15 qershor të atij viti në Kuvendin e Prizrenit, u parashtrua tashmë njëzëri nga përfaqësues të Shqipërisë Veriore dhe Shqipërisë Jugore në Dibër. Edhe pas afro dy vjetësh po në këtë qytet do të mbahet Kuvendi i quajtur i jashtëzakonshëm. Në të u trajtuan tri çështje me rëndësi vendimtare për Shqipërinë: qëndrimin ndaj çështjes së Ulqinit, krijimin e një vilajeti autonom dhe formimin e qeverisë së përkohshme. Edhe ky u zhvillua nën drejtimin e Iljaz Pashë Dibrës.

S u m m a r y

THE FIRST ASSEMBLY OF DIBRA (1^{RST} NOVEMBER 1878)

The Assembly of Dibra convened in the atmosphere created after the armed action in Gjakova against the mission of Mehmed Ali Pasha Maxharri and his Albanians supporters, led by Abdullah Pasha Dreni. The failure of the Ottoman imperial authorities in Gjakova by forcing Albanians, not to oppose the implementation of the decisions in the Berlin Congress to submit Gucia and Plava, increased the determination of radical leaders of the League to the submit pan-Albanian applications for autonomy presented once again to the High Ottoman Port by the Assembly of Prizren on 15 June.

In the course of actions for the implementation of a joint action coordinated at the national level in support of the demand for autonomy of the

1922. Në garë me të hynte dhe kushëriri i tij, Mehdiu, i cili e paraqet atë, në vitin 1938 si “prurës i një ideje dhe i një ideali të ri.” Madje, shkon më tej dhe mëton që Abdyli “me ndihmën e një kulture oksidentale formoi qendrën e Frashërit; hartoi programin dhe me një shpirt therorije i ndryshoi faqen Lidhjes dhe i dha frymë nacionale dhe kuptimin evropian”. (Mehdi Frashëri, *Lidhja e Prizrenit edhe efeltet diplomatike të saj*, Tiranë: 1938, f. 3-4.) Dega e pretenduar e Lidhjes në Frashër, siç shihet, paraqitet si qendër oksidentale e Lidhjes.

Albanian Vilayet, the League of Prizren carried out on 1 November 1878, the Assembly of Debar headed by Iljaz Pashë Dibra. Together with other representatives of the League of Toskëria Abdul Frashëri signed on 1st November 1878 the requirements adopted in Dibra at 14 October 1878.

The inclusive Resolution of the Assembly of Dibra contained requests, summarized in five points: the formation of the Vilayet of Albania, supplying it with the albnian clerks, development of education in the Albanian language, the implementation of reforms by the Grand National Assembly and the use of a large part of budget for the advancement of education and for the world-constructions.

The Leadership of the League would not consider as Albanians the opponents of the autonomist program, but as enemies of “the homeland of our people”. In this formulation, it seems clear that the delegates of the Assembly of Dibra did not mind the “Ottoman” motherland and the “Islamic millet”, but only the Albanian people and his homeland, Albania.

The viewing or the program-documents of the Albanian League approved and announced in ten days of the second month of June in rattling year 1878 in Prizren, and on October 14 and 1st November of that year in Dibra proves that was submitted already unanimously by Albanian representatives from the Northern and Southern Albania. Dibra, this center important in this national process, after about two years would keep again the Assembly called extraordinary. In this Assambly were treated three issues of crucial importance for Albania: the attitude towards the issue of Ulcinj; creating an autonomous Vilayet and the formation of the interim government. The role of Iljaz Pashë Dibra in these developments was primary.